



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 14.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 09.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INTEGRAL SHPK&Milenium Construction" për aktivitetin :"**Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1015-511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "INTEGRAL SHPK&Milenium Construction" e datës 09.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte**" me numër të prokurimit: 616 -19-1015-511, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së , të datës 07.09.2020 të publikuar në Platformën e KRPP-se-E Prokurimi.
2. Vertetohet Njoftimi i Vendimit për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 07.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas te njejtit Njoftim*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Integral SHPK&Milenium Konstruktion**" me datë 09.09.2020 ka parashtruar kerkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Vazhdimi i rruges B-pjesa e dyte**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1015-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.09.2020, ka shqyrtuar kerkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Pretendimi kryesor është se Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar si duhet deshmite e ofruara për kryerjen e punëve të ngjajshme duke mos analizuar disa kontrata që kanë emertimin si mirembajtje e rrugëve, mirepo në kuader të tyre ka shumë punime të ngjajshme si që janë kerkuar në këto aktivitete është në kundërshtim me rekomandimet e Vendimit të OSHP-se, respektivisht me pasusin 3 nga faqja 7 ku shkruan: "Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ketij

pretendimi ankimor sqaron se ky pretendim ankimor eshte pjesisht i bazuar per shkak se OE-ik i rekomanduar per dhenje te kontrates "Integral SHPK&Milenium Konstruktion SHPK"ka prezentuar kontrata te mirembajtjes.Pra ,autoriteti kontraktues duhet qe te ekzaminoj drejt keto kontrata nese jane per mirembajtje apo te natyres se punes se ngjajshme sikurse ka kerkuar autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit.Komisioni i rivleresimit bazuar ne kete spjegim te OSHP-se ka konstauar se kontratat e mirembajtjes nuk jane kontrata te natyres se ngjajshme si qe eshte kerkuar ne dosjen e tenderit dhe i ka trajtuar si te tilla.

-Pretendimi juaj se me pare sipas nje kerkese paraprake per rishqyrtim jane marre per baze edhe punimet nga kontratat e mirembajtjes ju sqaroj se ato jane pranuar ne baze te kerkeses tuaj,por tani jane ne kundershtim me Vendimin e OSHP-se dhe natyrisht se çfaredo konstatimi im qe eshte ne kundershtim me te njejtin duhet te çfuqizohet.

-Lidhur me pretendimin se AK-ja eshte dashte sipas Vendimit te kerkoj sqarime lidhur me disa kontrate mund te vereni se komisioni i rivleresimit ka konstatuar se edhe nese ato jane te pranueshme ju nuk plotesoni kerkesen e dosjes se tenderit per realizim te kontratave te ngjajshme ne vleren e kerkuar prej 3.000,000.00 euro.Pra kjo kerkese nuk eshte bere per arsyen se edhe si te pranueshme ato kontrata nuk ndihmojne ne plotesimin e kerkeses nga dosja e tenderit;dhe

-Lidhur me pretendimin tuaj se AK-ja perdor kriteret te dyfishta ju sqaroj se ky pretendim eshte tendencioz dhe nuk ka lidhje me aktivitetin per te cilin keni parashtruar kerkesen tuaj per rishqyrtim.Ua perkujtoj se ne kete aktivitet per te cilin keni paraqitur kerkesen tuaj,askush nuk ka kerkuar sqarime lidhur me permbajtjen e kontratave qe jane te sherbimeve e qe kane ne brendi pune te ngjajshme apo te njejta me aktivitetin tjeter konkret dhe si te tilla nuk mund e vlejne dhe te zbatohen per nje aktivitet tjeter dhe ate ne menyre retroaktive pas nje periudhe nentemujore.

Bazuar ne sqarimet paraprake ju sqaroj se eshte vendosur si ne dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit